



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 89/2012
Prishtinë, më 18.12.2012, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha–Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Fikrim Damka, Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Burim Ejupi, Dita Dobranja – INDEP; Florije Mehmeti – KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 11.12.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2012;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 11.12.2012

Procesverbali i mbledhjes së datës 11.12.2012, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2012

Kryetari – Kam kërkuar nga stafi i Komisionit, që të hartojë këtë Raport, duke paraqitur punën që është bërë gjatë vitit 2012. Theksoi se gjatë shqyrtimit të Raportit të punës për vitin 2012, ne mund të shtojmë edhe ndonjë aktivitet që nuk është cekur në këtë draft. Ai tha se puna e Komisionit gjatë vitit 2012, është bazuar kryesisht në Planin e punës së Komisionit, i cili është hartuar duke u bazuar në Strategjinë legjislativë të Qeverisë. Pastaj hapi debatin për anëtarët e Komisionit.

Teuta Sahatqija – Kërkoi sqarim lidhur me pikën e Raportit, për shqyrtimin e projektligjeve dhe tha se, në faqen gjashtë (6), është shënuar se janë miratuar gjithsej 7 projektligje, ndërsa në faqen 11 të raportit, në tabelë është cekur se janë miratuar 9 projektligje. Kërkoi që nëse është ndonjë gabim teknik, kjo pikë të rregullohet dhe të dihet se cilat projektligje janë tërhequr nga ana e Qeverisë dhe cilat janë kthyer nga ana e Kuvendit.

Sala Berisha-Shala – Ky raport e pasqyron vërtet punën e mirë që kemi bërë si Komision Funkcional gjatë vitit 2012, po ashtu edhe nismat ligjore dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve që ka bërë Komisioni me vetiniciativë. Theksoi se mbetet shqetësuese që Komisioni, gjatë vitit 2012, nuk ka realizuar asnjë vizitë jashtë vendit, për t'i parë përvojat e shteteve të tjera dhe për të shkëmbyer përvoja si homolog me komisionet e parlamenteve të ndonjë shteti.

Visar Ymeri – Tha se Raporti duhet të jetë më i detajuar, duke pasur një pjesë të diskutimeve se si janë zhvilluar aktivitetet, për punën që ka bërë Komisioni gjatë vitit 2012. Propozoi që një pikë e raportit, të përmbajë punën e realizuar të planit vjetor të vitit 2012, të ceket se sa është realizuar Plan i punës së Komisionit për vitin 2012, i cili është hartuar mbi bazën e Strategjisë legjislativë të ekzekutivit (Qeverisë), si dhe të ceket aty pse nuk është realizuar, për shkak të mosardhjes me kohë të ligjeve nga ana e Qeverisë.

Kryetari – Propozoi që Raporti i punës së Komisionit për vitin 2012, të votohet me ndryshimet e propozuara nga ana e anëtarëve të Komisionit, në mënyrë që të plotësohet me të dhëna shtesë, duke pasqyruar shkaqet e mospërmbushjes në tërësi të Planit të punës për vitin 2012.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti i punës së Komisionit për vitin 2012, me ndryshimet e propozuara

4. Të ndryshme

Kryetari - Kërkoi nga stafi i Komisionit, që të hartojë një letër falënderimi për Institutin Demokratik Kombëtar (NDI), për mbështetjen që na ka ofruar përmes konsulentit ligjor.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit